

Sektori i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 22.12.2021, miratoi këtë:

## M E N D I M   J U R I D I K

**Pronar i automjetit motorik udhëtues është personi, automjeti i të cilit në bazë të kontratës me shkrim i është dorëzuar në zotërim, pavarësisht që ai ndryshim nuk është regjistruar në regjistrat e shënuar me ligj.**

### A r s y e t i m

Në përputhje me nenin 145 paragrafi (1) të Ligjit për pronësi dhe të drejta tjera reale (më tej LPDTR) e drejta e pronësisë të sendit të tundshëm kalon te përfituesi me dorëzimin e sendit në zotërim të tij. Me këtë nen, rregullohet mënyra e përfitimit të pronësisë te sendet e tundshme edhe atë me dorëzimin fizik, real të sendit (nga dora në dorë). Pastaj, parim është që sendi të dorëzohet në zotërim të drejtpërdrejtë me dorëzimin fizik, dhe në zotërim indirekt – me një deklaratë boshe të vullnetit. Megjithatë, në çdo rast dorëzimi i zotërimit duhet të përfaqësojë veprim si shprehje të deklaratës së dyanshme të vullneteve të poseduesit të deriatëhershëm se e dorëzon qeverisjen faktike lidhur me sendin e përfituesit dhe deklaratën e vullnetit të përfituesit se e pranon sendin. Pronësia e sendit të tundshëm, përfitohet me dorëzimin e sendit në zotërim të pavarur të përfituesit, nëse ai dorëzim është themeluar me veprimin juridik të tjetërsuesit, drejtuar bartjes të pronësisë së atij sendi ndaj përfituesit, ndërsa tjetërsuesi është pronar i sendit që është i autorizuar ashtu me atë të disponojë. Veprimi juridik mund të jetë i njëanshëm (testament) ose i dyanshëm (kontratë).

Sipas kësaj, vetë dorëzimi i zotërimit nga një person në tjetër pa bazën juridike për atë madje bile edhe me vullnetin e zotërimit që të dorëzohet, përkatësisht të përfitohet nuk paraqet ndonjë kontratë të veçantë, të caktuar, reale që do të çon në përfitimin e zotërimit pronësor. Dorëzimi i zotërimit që themelohet me bazë juridike me të cilën kontraktohet përfitimi i të drejtës së pronësisë paraqet realizimin e përmbajtjes së asaj baze që do të thotë të çështjes juridike, sipas rregullit kontrata e lidhur me vullnet të bartet, përkatësisht të përfitohet e drejta e pronësisë.

Kjo rrjedh edhe nga neni 146 nga ligji i sipërcituar (LPDTR), ku në paragrafin (1) thuhet: “Kur më tepër persona kanë lidhur veprime të veçanta juridike për shkak të përfitimit të së drejtës së pronësisë të sendit të njëjtë të tundshëm e caktuar individualisht, atë të drejtë e përfiton personi të cilit së pari i është dorëzuar sendi, nëse janë përmbushur edhe të gjitha supozimet tjera për përfitimin e pronësisë. Me këtë dispozitë, rregullohet situata juridike që paraqitet kur pronari ua tjetërsion sendin e tij disa personave në kohë të ndryshme me veprime të veçanta juridike, me të cilat përfitohet e drejta e pronësisë dhe në atë kuptim theksohet se të drejtën e pronësisë në bazë të veprimit juridik e përfiton personi, të cilit së pari i është dhënë sendi pa

marrë parasysh se nëse ai person është i pari me të cilin është lidhur kontrata ose ai është njëri nga personat e ardhshëm me të cilët është lidhur kontrata.

Ajo që, pronari i ri i sendit të tundshëm-automjetit motorik, nuk e ka regjistruar ndryshimin e pronësisë për të njëjtën në regjistrat e paraparë me ligj është e parëndësishme, ngase në nenet e cituara 145 dhe 146 të LPDTR ajo nuk është theksuar si kusht. Për dallim të kësaj, në nenin 148 paragrafi (1) të LPDTR në mënyrë të prerë qëndron se e drejta e pronësisë së patundshmërisë në bazë të veprimit juridik përfitohet me regjistrimin në librin publik për regjistrimin e të drejtave të patundshmërive ose në një mënyrë tjetër përkatëse të përcaktuar me ligj. Do të thotë se, në vet Ligjin për pronësi dhe të drejta tjera reale, që është lex specialis lidhur me rregullimin e mënyrës së përfitimit të së drejtës së pronësisë të sendeve të tundshme dhe të patundshme bëhet dallimi, më saktë se për sendet e tundshme nuk duhet regjistrimi i ndryshimeve të pronësisë në regjistrat me ligj të parapara për dallim nga sendet e patundshme për të cilat kërkohet ndryshimi i pronësisë që të regjistrohet në librin publik për regjistrimin e të drejtave të patundshmërive. Në qoftë se, nuk është bërë ndryshimi i pronësisë të sendit të tundshëm nga pronari i mëparshëm në pronarin e ri, për atë parashihet kundërvajtje e veçantë në përputhje me Ligjin për automjetet dhe Ligjin për siguri në komunikacion rrugor.

**GJYKATA SUPREME E  
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT  
SEKTORI I VEPRAVE CIVILE**